



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY  
Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383-38-548 644 URL: <http://www.fna.uni-pr.edu> Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 1616/p Prishtinë 28.06. 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER  
DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Egzon Behluli** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " **Analiza e ndërtimit të HEC në lumin e Erenikut** " në programin e studimeve Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

**ABSTRAKTI**

Në zhvillimin ekonomik-shoqëror të një vendi, gjithnjë në përputhje me parimin universal të zhvillimit të qendrueshëm, marrin rëndësi të vecantë gjetja e rrugeve dhe teknologjive më efikase, si për shfrytëzimin sa më racional të pasurive natyrore, ashtu edhe për kontrollin cilësor dhe sasior të ndikimit mbi mjedis, dhe sidomos në burimet ujore. Me zhvillimin e ekonomisë dhe së fundmi zhvillimi i teknologjisë në një shkallë shumë të lartë, në mënyrë racionale ka kushtëzuar edhe nevojën për energji elektrike si elementin kryesor për zhvillim. Energjia e prodhuar përmes hidrocentralit mbështetet në ciklin e ujit, i cili është i drejtuar nga dielli, duke e bërë atë një burim të rinovueshëm të energjisë dhe më të përballueshëm sesa lëndët djegëse që janë duke u zvogluar me shpejtësi.

Rajoni i Kosovës Jugperendimore, ku bënë pjesë dhe lugina e lumit Erenik, që derdhet në Lumin e Drinit të Bardhë, e zgjedhur për ndërtimin e hidrocentraleve është ndër hapësirat më të rëndësishme dhe më të vlefshme të vendit, e pare nga dy këndvështrime, nga ai i zhvillimit ekonomik dhe i vlerave mjedisore që ajo paraqet.

Në këtë punim synohet të trajtohet ndërtimi i hidrocentrale në lumin Erenik në rajonin e Junikut të cilat kanë kapacitet për prodhimin e energjisë së ripërtrishme. Së pari është bërë analiza hidrologjike për këtë pellgë dhe elementet kryesore të hidrocentralit.

Në hidrocentralet e lumit Erenik do të ndërtohen tri (3) vepra të marrjes, dy ndërtesa të centralit, tri basene të presionit, dhoma për kontrollimin e prurjeve.

Vepra e marrjes 1 do të ndërtohet në vendin e quajtur Mal i madhë, përmes kanalit të hapur uji do të kalojë tek sedimentuesi, pastaj tek bazeni i presionit nga aty përmes derivacionit të gypit të qelikut me prurje  $Q_u = 2.34m^3/s$  tek dhoma e turbinave (në vendin e quajtur bashkimi i erenikëve) ku në të njejtin lokacion do të instalohet edhe turbina për veprën e marrjes 2 (Ereniku i vogël) me prurje  $Q_u = 1.257m^3/s$ . Ndërsa vepra e marrjes 3 do të ndërtohet në afërsin e zonës së bashkimit të dy erenikëve, nga e cila do të furnizohet me prurje nga pellgu me sipërfaqe  $S=32,5 km^2$ , ku përmes derivacionit me gypë të qeliku me gjatësi  $L=2933m$  dhe prurje  $Q_u = 2.7m^3/s$  dërgon ujin tek ndërtesa e turbinave tek vendi i quajtur Qafa Jasiqit.

Përfitimi vjetor i energjisë nga keto hidrocentrale do të jetë  $N = 12426 kW$ , ndërsa analiza e kostos dhe periudha e kthimit të mjeteve është bërë përmes programit për studim fizibiliteti RETScreen Expert.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.